

L I G J
Nr. 8087, datë 13.3.1996

**PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE SHËRBIMIT
INFORMATIV KOMBËTAR**

*(Ndryshuar me ligjet; nr. 8521¹, datë 30.7.1999; nr. 8918, datë 4.7.2002; nr. 8948,
datë 3.10.2002)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Ligji për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u garanton pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të përcaktuar në ligjin nr.7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe anëtarëve të familjeve të tyre përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 1/1

(Shtuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

Përfitojnë sipas këtij ligji ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ish-ushtarakët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Vjetërsia e shërbimit si ushtarak aktiv për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi llogaritet nga dita e titullimit oficer apo nënoficer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe të ish-Ministrisë së Brendshme.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

¹ Ligji nr. 8521, datë 30.7.1999 në nenin 10 shprehet;
“Efektet e zbatimit të këtij ligji shtrihen nga data 1 janar 1999.”

Përfitimet nga ky ligj financohen dhe garantohen nga buxheti i shtetit. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenet 8, 10 e 17 bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë udhëzimin përkatës.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

Të drejtën e përfitimit, sipas këtij ligji, e kanë ushtarakët që kanë dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7496, datë 3. 7. 1991 “Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen.

FUSHA E MBROJTJES

Neni 5

Ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ish-Ministrisë së Brendshme kanë të drejtë për:

- Përfitim suplementar për paaftësi të përkohshme në punë.
- Parandalim dhe rehabilitim për sëmundje.
- Pagesa kalimtare kur nxirren në lirim.
- Pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.
- Pension suplementar pleqërie për ushtarakët me status.
- Pension suplementar invaliditeti.
- Pension suplementar invaliditeti për ushtarakët që për shkak të detyrës bëhen të paaftë plotësisht.
- Pension suplementar familjar.
- Pension suplementar familjar për ushtarakët që për shkak të detyrës humbasin jetën.
- Pagesë suplementare në rast vdekjeje.

Neni 6

Ankimet kundër vendimeve për përfitime nga ky ligj bëhen në gjykatë, e cila e zgjidh çështjen përfundimisht.

PJESA E DYTË

Neni 7

Kushtet për përfitim

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999; shtuar paragraf me ligjin nr. 8918, datë 4.7.2002)

E drejta e përfitimeve suplementare për ushtarakët, sipas këtij ligji varet nga vitet e shërbimit në Forcat e Armatosura paga referuese dhe shuma e pensioneve të llogaritura.

Në llogaritjen e vjetërsisë së shërbimit, veç viteve të plota, periudha që mbetet kur është mbi 6 muaj, llogaritet vit i plotë; në të kundërt nuk merret parasysh për efekt llogaritjeje.

Në kohën e shërbimit aktiv përfshihet:

Koha si punonjës i reparteve të Radiozbulimit të Forcave të Armatosura që, sipas funksionit organik, kanë kryer detyrën e punonjësit të drejtimit dhe të operatorit të radiozbulimit (punonjës posti) si punonjës civil para titullimit ose rritullimit si ushtarak aktiv.

Koha e shërbimit të përhershëm (oficer, nënoficer, polic, ushtarë rogtarë).

Koha e pjesëmarrjes në operacionet luftarake, brenda e jashtë vendit, koha e shërbimit aktiv të përhershëm të ushtarakëve në repartet speciale, të luftës kundër terrorit, drogës, trafikut të paligjshëm dhe krimit të organizuar, në aviacionin ushtarak (pilotët, bordteknikët, aviondrejtuesit, radistët fluturues e shenjues); në FLD (nënujësit të trajtuar të tillë me organikë), në strukturat e zhytjes në Forcat e Armatosura, si dhe në të gjitha ato struktura të konsideruara të tilla me vendime të Këshillit të Ministrave, llogaritet 1.5 fish.

Koha e plotë e vuajtjes së dënimit ose internimit për motive politike, para titullimit si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm, kur përfitohet nga ligji nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe kur kanë jo më pak se 5 vjet në strukturat e Forcave të Armatosura.

Paga referuese është paga bazë për funksionin dhe shpërblimi për gradën ushtarake që kishte ushtaraku në çastin e daljes në rezervë apo në lirim.

Pagë bazë për efekt përfitimi nga ky ligj konsiderohet:

a) Për ushtarakun që ka dalë në rezervë ose lirim para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji është paga që ka ushtaraku në po atë funksion në momentin e shtrirjes së efekteve financiare të këtij ligji.

b) Për ushtarakun që del në rezervë ose lirim pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, është paga që ka ushtaraku në po atë funksion në momentin që lind e drejta e përfitimit.

I. PËRFITIMI SUPLEMENTAR PËR PAAFTËSI TË PËRKOHSHME NË PUNË

Neni 8

Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm, për kohën që bëhet i paaftë për punë, merr përfitime suplementare të llogaritura mbi pagën mesatare ditore neto të muajit të fundit kalendarik të shërbimit:

a) 20% nga dita e pesëmbëdhjetë e paaftësisë e në vazhdim;

b) 10% për periudhën e shtrimit në spital, kur ka persona në ngarkim.

Kur paaftësia e zakonshme zgjat deri në 14 ditë, ushtaraku përfiton pagën referuese.

Neni 9

Rehabilitimi dhe parandalimi për sëmundje

Ushtaraku, sipas përcaktimit të bërë nga KMU pranë SQU, gëzon të drejtën e rehabilitimit dhe parandalimit për sëmundje në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Pagesa kalimtare

Ushtaraku që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji,

a) është bërë i paaftë profesionalisht për të kryer shërbimin e që ka një periudhë shërbimi me status në Forcat e Armatosura jo më pak se 1 vit, ose

b) nxirret në rezervë (lirim) për papërshtatshmëri a për efekt të reformës në Forca të Armatosura, merr pagesë kalimtare në masën e dy rrogave-bazë mujore si shpërblim të menjëhershëm dhe mbas këtij shpërblimi merr 50% të pagës referuese, për aq kohë sa kanë

qenë me status, por jo më tepër se 2 vjet për burrat dhe tre vjet për gratë.

Në çdo rast punësimi gjatë kësaj periudhe, masa e pagesës kalimtare do të jetë deri në kompensimin e pagës, mbi të cilën është llogaritur pagesa, por në çdo rast jo më shumë se kjo pagesë.

Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare për efekt të zbatimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 quhet periudhë sigurimi. Kontributi për këto kategori përballohet nga buxheti i shtetit.

Neni 11

Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë e në lirim pas datës 3. 7. 1991 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarak në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kenë mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç.

Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të jetë:

a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi.

b) Për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet pasi përfituesit i ka përfunduar periudha e trajtimit me pagesë kalimtare, sipas nenit 10 të ligjit nr. 8087, datë 13. 3. 1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe ish-Ministrisë së Brendshme.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur përfituesi rritullohet ushtarak aktiv apo punësohet.

Periudha që ushtaraku përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi njihet si vjetërsi sigurimi për efekt përfitimi pension pleqërie, sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 12

Pensioni suplementar i pleqërisë për ushtarakët me status

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

Ushtaraku, që është efektiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i Ministrisë së Rendit Publik, i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe i ish-Ministrisë së Brendshme, kur ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 4171, datë 13. 9. 1966 “Për sigurimet shoqërore në RPSH” dhe të ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të marrë pension suplementar pleqërie si ushtarak.

Kjo shtesë llogaritet 1% për çdo vit mbi pagën referuese me status në Forcat e Armatosura.

Pensioni suplementar i pleqërisë për ushtarakët me status nuk mund të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë.

Neni 13

Pensioni suplementar i invaliditetit

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999)

Ushtaraku, që është efektiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i Ministrisë së Rendit Publik, i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe i ish-Ministrisë së Brendshme, përfiton pension invaliditeti të plotë a të pjesshëm, sipas ligjit nr. 4171, datë 13. 9. 1966 “Për sigurimet shoqërore në RPSH” dhe ligjit nr. 7703, datë 11. 5. 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, gëzon edhe të drejtën e pensionit suplementar të invaliditetit si ushtarak.

Kjo shtesë llogaritet 1% për çdo vit mbi pagën referuese me status në Forcat e Armatosura.

Pensioni suplementar i invaliditetit nuk mund të jetë më i lartë se 50% e pensionit të invaliditetit.

Neni 14

Pensioni suplementar i invaliditetit për ushtarakët që për shkak të detyrës bëhen të paaftë plotësisht

Ushtaraku që për shkak të detyrës deklarohet i paaftë plotësisht, merr pension suplementar invaliditeti në masën 20% të pagës referuese.

Shuma e pensionit suplementar dhe e pensionit të invaliditetit që merret sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” nuk duhet të jetë më e lartë se paga që llogaritet ky pension.

Neni 15

Pensioni suplementar familjar

Personat që janë në ngarkim të ushtarakut të shërbimit aktiv që vdes dhe përfitojnë pension familjar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” marrin pension suplementar familjar si vijon:

50% burri dhe gruaja e ve dhe 25% për çdo jetim, prindër, nip/mbesë dhe prind të prindit, me kufi maksimal shumë e plotë prej 100% të pensionit suplementar që i ndjeri do të merrte sipas këtij ligji.

Neni 16

Pensioni suplementar familjar për ushtarakët që për shkak të detyrës humbasin jetën

Pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut që për shkak të detyrës humbet jetën, përfitojnë pension suplementar në masën e diferencës ndërmjet pagës referuese dhe pensionit familjar që përfitojnë sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 17

Pagesa suplementare për rast vdekjeje

Pjesëtarët e familjet së ushtarakut aktiv, i cili vdes gjatë kryerjes së shërbimit ose për shkak të detyrës, përfitojnë pagesë suplementare për rast vdekjeje. Gjithashtu këtë të drejtë e gëzojnë edhe pjesëtarët e familjes të ushtarakut, i cili vdes duke qenë me pagesë kalimtare ose

në pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Masa e pagesës për rast vdekjeje përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Përfitimet suplementare të pensioneve dhe pagesa kalimtare indeksohen sa herë që indeksohen pensionet e pleqërisë.

Neni 19

Ky ligj nuk përjashton përfitimet që jepen me dispozita të tjera ligjore.

Neni 19/1

(Shtuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999; ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8948, datë 3.10.2002)

Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake.

Ushtarakët, që nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të nenit 19/1 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar në ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999, të cilët nuk janë dënuar me burg me vendim gjyqësor të formës së prerë për krime ushtarake, përfitojnë të drejtën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve, nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitim.

Neni 20

Ushtarakët që trajtohen financiarisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 10.1.1996 “Për pagesën e ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”, do të vazhdojnë të trajtohen sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 21

Këshilli i Ministrave merr të gjitha masat e nevojshme për vënien në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 22

Ligjet dhe çdo akt tjetër nënligjor që bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr. 1435, datë 28.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

